



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____/____/ 2026

Lënda: Kërkesë për marrjen e masës disiplinore dhe referimin menjëherë pranë organeve të Prokurorisë, në rastin në fjalë Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të deputetit Agron Shehaj

Drejtuar: **Z. NIKO PELESHI**
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË
SEKRETARIATIT PËR PROCEDURAT, VOTIMET DHE ETIKËN

Baza Ligjore: *Neni 63 dhe neni 65/1 pika 1, 6 dhe pika 7, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
Neni 6 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.*

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën,

Në Seancën Plenare të Kuvendit të Shqipërisë të datës 27 korrik 2026 e filluar ora 10.00, gjatë diskutimit të procedurës për shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas direkte, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

përfaqësuar nga Agjencia e Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), në kuadër të financimit të jashtëm ushtarak (FMF)”, deputetët u informuan nga Kryetari i Kuvendit zoti Niko Peleshi se kjo Marrëveshje përmban informacion të klasifikuar e për pasojë deputetët që duan të njihen me të duhet të zbatojnë parashikimet dhe detyrimet e ligjit, duke u paraqitur pranë sekretarisë, në sallën “Gerti Bogdani”, ku të firmosin paraprakisht një Deklaratë Konfidencialiteti dhe se nuk mund të marrin ose të riprodhojnë kopje të këtij dokumenti.

Deputeti Agron Shehaj u paraqit në sallën “Gerti Bogdani” dhe në shkelje të ligjit insistoi ta merrte kopjen fizike me vete. Stafi i Kuvendit e sqaroi se, në zbatim të ligjit materiali mund të lexohej vetëm brenda sallës dhe kopja nuk lejohej të dilte prej sallës. Deputeti nuk pranoi këtë sqarim ligjor, e grabiti me forcë materialin dhe u largua bashkë me të. Këshilltarja e ndoqi deputetin dhe në përpjekje për ta ndaluar dhe ta rimarrë dokumentin, u rrëzua nga shkallët dhe pësoi lëndime të rënda, siç vërtetohet dhe nga pamjet video bashkangjitur kësaj kërkesë.

Deputeti Agron Shehaj, me sjelljet e tij të përsëritura të dhunshme dhe agresive ka vënë në rrezik këshilltaren e cila është gjendur e pambrojtur përballë kësaj sjellje të dhunshme dhe të papranueshme.

Këto sjellje çenojnë rëndë dhe në mënyrë të patolerueshme sigurinë e stafit të Kuvendit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Sjellja e deputetit duke marrë me forcë dhe duke nxjerr jashtë sallës dokumentin e klasifikuar përbën shkelje të rëndë të legjislacionit për informacionin e klasifikuar.

Për sa më sipër, *bazuar në nenin 63, dhe nenin 65/1 pika 1,6 dhe pika 7, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar; dhe nenit 6 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë*, paraqesim kërkesën si më poshtë:

Marrjen e masës disiplinore “Përfshirje nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare” për 60 ditë ndaj deputetin Agron Shehaj, për sjellje të përsëritura të dhunshme dhe agresive duke vënë në rrezik stafin e Kuvendit, dhe duke marrë me forcë dhe nxjerr jashtë sallës materialin e klasifikuar, që përbën shkelje flagrante të legjislacionit për informacionin e klasifikuar.

Gjithashtu referuar parashikimeve të Kodit Penal, nenet 139-142, 294-296, 235, t’i referohet mënjëherë Prokurorisë, në rastin në fjalë Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me dyshimet se shtetasi Agron Shehaj ka kryer veprat penale:

- (i) përvetësimi ose marrja e paligjshme e informacionit të klasifikuar, duke qenë se dokumenti përmban informacion që mbrohet me ligj;
- (ii) (ii) vjedhja ose forma të tjera të përvetësimit të paligjshëm, për shkak të mënyrës së marrjes;
- (iii) (iii) grabitja sepse dokumenti është marrë me përdorim force ose kërcënim ndaj personit që e mbante;
- (iv) (iv) pengimi i detyrës së funksionarit publik sepse forca është ushtruar ndaj një punonjësi publik gjatë ushtrimit të detyrës;
- (v) (v) dokumenti lidhet me sekretin shtetëror dhe në këtë rast mund të verifikohen edhe dispozita të posaçme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të cilat parashikojnë vepra më të rënda penale, sidomos kur veprimi cënon sigurinë kombëtare dhe personi i dyshuar mund të ketë synuar dorëzimin e këtij materiali aktorëve të tjerë, të paidentifikuar nga ne, por që duhet të hetohen nga prokurorët.